

Adriana Qafa¹ & Andrea Llukani² MITROPOLIA E BERATIT NË SHEKUJ

ABSTRACT

The Metropolitanate of Berat originates from the apostolic years. The southern branch of the Egnatia Road passed through Apollo at the station the Romans called Clodiana. The Christianization of Apollonia is thought to have been done in the first century after Christ by the apostle Paul, who handed Marin to the episcopal rank. In the Codex of the Jerusalem Library, Marini is ranked 56th after St. Qesar, the bishop of Durrës. At the time of Diocletian, in the c. II AD the city of Berat was included in the province of New Epirus. In the 5th century, Pulqeria, the sister of Theodos the Great, ascended the throne of the Byzantine Empire. She married the elder Marcian and they visited the city of Antipatrea (Beratin), which she baptized with her name Πουλχεριούπολις (Pulqerionopolis), which means the city of Pulqeria. In 860 Berat was engulfed by the first wave of the Bulgarian invasion, which lasted until 927. Despite the invasion by the barbarians, the population continued to preserve the Christian faith. The greatness of Christianity in the lands of Illyria made even the Bulgarian conquerors embrace the Christian religion. After this year, Byzantine rule returned to Berat, which continued until 969. After this year, the second wave of the Bulgarian invasion began, which continued until 1018. At this time, the Bulgarians called Berat Belgrade, which means city of white. In the letter that the Pope of Rome John XII sends to Boris of the Bulgarians, he appreciates Belgrade as an important episcopal seat. While Theophylact of Ohrid appreciates the bishop of Berat as "a man who shines with knowledge". With the establishment of the Archbishopric of Ohrid in 1020, Berat came under the jurisdiction of this bishopric. With the fall of the Byzantine Empire in 1204, Berat became one of the most important seats of the Despotate of Epirus. In 1417, Berat was conquered by the Ottomans during the reign of Sultan Mehmet Ngadhenjmtar. Berat got its name in 1431, at the time of the Ottoman occupation. So first it was called Antipatrea, then Pulqerionopolis, Belgrade and finally Berat.

Keywords: Metropolis of Berat, Egnatia Road, Antipatrea, Pulqerionopolis, Belgrade, Berat

ABSTRAKT

Mitropolia e Beratit e ka origjinën që nga vitet apostolike. Nëpër Apoloni kalonte dega jugore e Udhës Egnatia në stacionin që romakët e quanin Clodiana. Kristianizimi i Apolonisë mendohet të jetë bërë që në shekullin e parë pas Krishtit prej apostull Pavlit, i cili dorëzoi në gradën episkopale Marinin. Në Kodikun e Bibliotekës së Jerusalemit, Marini renditet në vendin e 56 pas shën Qesarit, episkopit të Durrësit. Në kohën e Dioklecianit, në shek. II pas Krishtit qyteti i Beratit përfshihej në provincën e Epirit të Ri. Në shekullin V në fronin e Perandorisë Bizantine u ngjiti Pulqeria, e motra e Theodosit të Madh. Ajo u martua me plakun Marcian dhe vizituan qytetin e Antipatreas (Beratin), të cilin e pagëzoi me emrin e saj Πουλχεριούπολις (Pulqerionopolis), që do të thotë qyteti i Pulqerias. Më 860 Beratin e përfshiu vala e parë e pushtimit bullgar, që zgjati deri në vitin 927. Megjithë pushtimin prej barbarëve, popullsia vazhdoi ta ruante besimin e krishterë. Madhështia e krishterimit në trevat e Ilirisë bëri që edhe pushtuesit bullgarë të përqaфонin fenë kristiane. Pas këtij viti në Berat u rikthye sundimi bizantin, që vazhdoi deri në vitin 969. Pas këtij viti filloi vala e dytë e pushtimit bullgar, që vazhdoi deri në vitin 1018. Në këtë kohë bullgarët Beratin e quajtën Belgrad, që do të thotë qytet i bardhë. Në letër që papa i Romës Joani XII i dërgon

¹PHD, Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Barleti", Tiranë, www.umb.edu.al, Rruga Sami Frashëri 41, Tiranë 1000, Republika e Shqipërisë, Tel: +355042430333 Email: edu.co@umb.edu.al

² Msc, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, Sheshi Skënderbej, Tiranë, Republika e Shqipërisë, www.mhk.gov.al, Tel: +355682087644, E-mail: llukaniandrea@gmail.com

Borisit të bullgarëve e vlerëson Beligradin si një seli të rëndësishme episkopale. Ndërsa Theofilakti i Ohrit e vlerëson episkopin e Beratit si “një njeri që shkëlqen nga dijet”. Me krijimin e Kryeepiskopatës së Ohrit më 1020, Berati kaloi në juridiksionin e kësaj episkopate. Me rënien e Perandorisë Bizantine më 1204, Berati u bë një nga selitë më të rëndësishme të Despotatit të Epirit. Në vitin 1417 Berati pushtohet nga osmanët gjatë sundimit të sulltan Mehmet Ngadhënjimtarit. Emrin Berat e mori në vitin 1431, në kohën e pushtimit osman. Pra fillimisht quhej Antipatrea, në vijim Pulqeripolis, Belgrad dhe më në fund Berat.

Fjalë kyçe: Mitropolia e Beratit, Udha Egnatia, Antipatrea, Pulqeripolis, Belgrad, Berat

Hyrje

Krishterimi në Mitropolinë e Beratit i ka fillimet nga vitet apostolike, d.m.th që në shekullin e parë pas Krishtit. Nëpër Apoloni kalonte dega jugore e Udhës Egnatia në stacionin që romakët e quanin *Clodiana*. Kristjanizimi i Apolonisë mendohet të jetë bërë që në shekullin e parë pas Krishtit prej apostull Pavlit, i cili dorëzoi në gradën episkopale Marinin. Në Kodikun e Bibliotekës së Jerusalemit, Marini renditet në vendin e 56 pas Shën Qesarit, episkopit të Durrësit¹. Në vitet e para të përhapjes së krishterimit në Apoloni është martirizuar Ibasi, i cili ishte me origjinë nga Athina. Gjithashtu në vitin 283 tre djem² nga Athina kishin ardhur në Apoloni për të predikuar krishterimin.

¹ Kondili, Pirro, *Apostull Pavli në viset e Shqipërisë së sotme*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 5.

² Dëshmorët e Apolonisë Feliksi, Hermesi dhe Pelegrini kanë jetuar në vitet e mbretërimit të perandorit Numerian. Ata flisnin për besimin e krishterë dhe për kotësitë e perëndive pagane. Tre djem të tjerë me origjinë nga Athina qenë larguar nga vendi i tyre dhe qenë vendosur në një shpellë pranë Apolonisë, ku bënë jetë asketike. Emrat e tyre qenë: dhjakoni Izaur dhe miqtë e tij Vasili e Inocenti. Djemtë shqiptarë dhe ata nga Athina kishin në shpirt një dëshirë. Kështu ata zunë miqësi me njëri-tjetrin. Një ditë djemtë nga Apolonia braktisën shtëpitë dhe u bashkuan me asketët, por kjo gjë nuk u pëlqeu prindërve të tyre, të cilët i denoncuan te prefekti i Apolonisë Triponti. Ky i fundit i arrestoi dhe u përpoq që t'i sillte përsëri në idhujtari, por djemtë iu përgjigjën se qenë të krishterë dhe do të vdisnin të tillë. Atëherë Prefekti urdhëroi që t'i dënonin me vdekje duke iu prerë kokat. Ndërsa Izauri, Vasili dhe Inocenti ranë në duart e të birit të prefektit Apolloni, i cili pasi i torturoi urdhëroi që t'u pritëshin kokat. Kisha jonë i kujton gjashtë martirët e Apolonisë më 17 qershor. Nga kjo dëshmi mësojmë se në rrethinat e Apolonisë ka pasur shpella asketike, të cilat u përdorën prej atyre të krishterëve, të cilët lanë kotësitë e kësaj bote dhe iu kushtuan lutjeve ndaj Perëndisë. Mitropoliti i Korçës Joani, *Martirët e shenjtë të Apolonisë*, Ngjallja, qershor 1995, faqe 7; Gjika, Ilirjan, *Apolonia, krishtërimi dhe Shën Pali*, Metropol, 16 prill 2007, faqe 20-21; Andrea Llukani, *Sinaksari i madh*, Trifon Xhagjika, Tiranë: 2012, faqe 185-186.

Krishtërimi nëtën e Aulonës është i hershëm. Këtë e dëshmon martirizimi i Elefterit¹, episkopit të Vlorës dhe Ilirisë në shek. II. Gjithashtu Shën Danaksi² (+300), që ka qenë anagnost i kishës së Vlorës dhe Ilirisë. Dëshmori Trifon³ i Sheqishtës (+313) përmendet nëpër sinaksarët e kishës se është kapur dhe varur mbi një shelg në vitin 313 pas Krishtit.

Në kohën e Dioklecianit, në shek. II pas Krishtit qyteti i Beratit përfshihej në provincën e Epirit të Ri⁴. Në shekullin V në fronin e Perandorisë Bizantine u ngjit Pulqeria⁵, e motra e Theodhosit të Madh. Ajo u martua me plakun Marcian dhe vizituan qytetin e Antipatreas (Beratin), të cilin e pagëzoi me emrin e saj Πουλχεριούπολις (Pulqeriopolis), që do të thotë *qyteti i Pulqerias*. Kjo e fundit ndërtoi

¹ Elefteri ka qenë episkop i Vlorës dhe i Ilirisë nga fillimi i shek. II pas Krishtit. Ai ka lindur në Romë dhe rridhte nga një familje fisnike e pasur. I ati që bashkëpunor i ngushtë i senatorit, ndërsa e ëma, Anthia, ishte grua shpresëtare. Me formimin dhe të edukimin e Elefeterit u mor e ëma, sepse i ati i vdiq shpejt duke e lënë jetim. Elefteri që në vogëli shquhej për thjeshtësinë, pastërtinë e karakterit dhe sidomos për dëshirën e zjarrtë për t'i shërbyer Perëndisë. Kur djali u rrit, e ëma ia dha episkopit të atëhershëm që ta kishte në kujdesin atëror. Episkopi i Romës, duke vënë re cilësitë e Elefterit të ri, e renditi në rreshtat e klerit duke e hirotonisur dhjak, pastaj prift e më vonë episkop. Pasi e hirotonisi episkop, e dërgoi për të lëçitur ungjillin në krahinën e Vlorës. Episkop Elefteri, sapo arriti në dioqezën e tij, nisi menjëherë misionin e tij për përhapjen e ungjillit në fiset pagane të këtyre anëve. Cilësitë e tij të shumta, çuditë që bënte dhe kthimet me shumicë në krishterim të paganëve shkaktuan urrejtjen dhe zëmërimin e perandorit romak Adrian, i cili shpalli një përndjekje të rreptë kundër të krishterëve dhe urdhëroi arrestimin dhe sjelljen në Romë të episkopit të Vlorës dhe Ilirisë Elefterit. Adriani u përpoq ta bindte me premtime të ndryshme që të mohonte Krishtin, por Elefteri qëndroi i patundur në besim. Më në fund i prenë kryet me shpatë në stadiumin e Romës. Po atë ditë i prenë kokën me shpatë edhe nënës së tij, Anthisë. Besimtarët nga Iliria që u ndodhën në Romë gjatë ekzekutimit, e morën trupin e Elefterit dhe atë të nënës së tij dhe i sollën në Vlorë, ku i varrosën me nderime. Shën Elefteri është mbrojtësi i grave shtatzëna, zbut dhimbjet dhe lehtëson lindjen, gjithashtu ai është mbrojtës i të burgosurve dhe çliruesi i njerëzve nga kurthet e djallit. Llukani, Andrea, *Sinaksari i madh*, Trifon Xhagjika, Tiranë: 2012, faqe 357-358.

² Sipas Sinaksarit të Nikodhim Agjioritit, Danaksi ishte ngarkuar me ruajtjen e objekteve të shenjta të kishës së Vlorës. Pasi nuk pranoi që t'u bënte fli idhujve, i prenë kokën me shpatë e kështu mori nga Perëndia aureolën e martirit. Kisha jonë e përkujton më 6 maj. Llukani, Andrea, *Sinaksari i madh*, Trifon Xhagjika, Tiranë: 2012, faqe 138.

³ Shën Trifoni është nderuar në Sheqishtë gjithmonë më 19 dhjetor.

⁴ Epiri i Ri shtrihej nga Drini deri në Vlorë, duke përfshirë edhe Elbasanin e Beratin, që në atë kohë quhej Pulqeriopolis dhe ishte ndërtuar nga perandori Theodhos për nder të motrës së tij Pulqeria. Kryeqendra e Epirit të Ri ishte Durrësi, prej nga fillonte Udha Egnatia. Qytete të tjera të kësaj province qenë Apolonia (Pojan), Amantia (Ploçë), Bylis (Gradishtë) dhe Aulona (Vlora). Zavalani, Tajar, *Histori e Shqipnis*, Phoenix, Londër: 1966, faqe 59.

⁵ Perandoresha Pulqeria (450-453) ka lindur në vitin 399 dhe ishte bija e perandorit Arkad (395-408) dhe motra e Teodosit II (408-450). Pas vdekjes së të atit ajo u shpall perandoreshë. Më 25-08-450 Pulqeria u martua me plakun Marcian. Perandoresha Pulqeria në vitin 431, thirri Sinodin III Ekumenik në Efes dhe më 451, Sinodin IV Ekumenik në Kalqedoni. Perandoresha Pulqeria themeloi shumë institucione bamirëse, gjithashtu ka ndërtuar shumë kisha. Me interesimin e saj në vitin 438, u sollën në Kostandinopojë lipsanet e Joan Gojartit, ndërsa në vitin 446 u sollën lipsanet e 40 shenjtoreve të Sebastisë.

Manastirin e Shën Mërisë Vllahernës dhe krishterimi në Episkopatën e Pulqeriopolit filloi të zhvillohej.

Episkopatat dhe pjesëmarrja e episkopëve në Sinodet Ekumenike

Në vëllimin VII të korpusit *Illyrikum Sacrum* përshkruhet themelimi i qyteteve dhe i episkopatave, duke e gërshetuar me historinë kishtare. Për këtë janë shfrytëzuar burimet e gjeografëve dhe historianëve më të shquar të atyre kohëve¹. Sipas Farlatit, episkopata e Pulqeriopolit ka qenë në varësi të Kryeepiskopatës së Durrësit. Në varësi të Kryeepiskopatës së Durrësit qenë edhe: 1. Lezha, 2. Arbëria, 3.

¹ Farlati, Daniele, Koleti, Jokob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilija, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963.

Kruja, 4. Benda, 5. Priska, 6. Shtjefni, 7. Kunavia, 8. Skampa, 9. Lestroni, 10. Bulida¹, 11. Amantia², 12. Apolonia³, 13. Valona⁴, 14. Pulqeripoli, 15. Akroçerani.

¹ Bulida ka qenë një qytet në Epirin e Ri, pranë Apolonisë.

² Episkopata e Amantias u themelua në fund të shekullit V para Krishtit. Ajo ndodhet në një kodër dhe është e fortifikuar me mure. Rrënojat e qytetit antik gjenden pranë fshatit të sotëm Ploc, në krahun e djathtë të lumit Shushica në rrethin e Vlorës. Amantia ishte qendra e një bashkësie ekonomike, shoqërore dhe politike që njihej me emrin grek Koinonoi (lidhja) dhe kishte një shtrirje gjeografike përgjatë luginës së Shushicës deri në Borsh. Gjithashtu në të përfshihej bregdeti i Vlorës që nga lugina e Nartës e deri në Ujin e Ftohtë. Në të përfshiheshin qytetet e Aulonës (Triporti) dhe Kaninës (Throni). Qendra të tjera qenë Olimpia (Mavrova), Dukaj, Cerja, Borshi etj. Amantia ishte qyteti kryesor i Koinonit. Stadiumi i Amantias është ndërtuar mbi një kodër me lartësi 600 metra nga niveli i detit dhe është një rast unik në Ballkan që një monument antik, që ka shërbyer si mjedis sportiv të ndërtohet në një lartësi të tillë. Ndërtimet në kalanë e qytetit u kryen në kohën e perandorit Justinian. Në vendin e quajtur “Lëmi i Peçit” gjenden rrënojat e një kishe paleokristiane e tipit bazilikë trinefëshe. Kisha përbëhet nga naosi, i cili ndahet nga tre nefa ku ai i qendrës është më i gjerë. Përsa i përket kohës së ndërtimit mendohet shekulli V. Amantia përmendet si qendër e rëndësishme episkopale në shekullin V. Ajo ka qenë në varësi të Kryepeshkopatës së Durrësit. Episkopi i Amantias Euali ka marrë pjesë në Sinodin e Sardikës. Ai nuk i pranoi vendimet e Sinodit dhe u largua prej tij bashkë me 71 episkopë të tjerë. Farlati, Daniele, Koleti, Jokob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilia, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963, faqe 185; Meksi, Aleksandër, *Kisha paleokristiane në qytetin e Amantias*, Albania, 7 shtator 2007, faqe 21; Llojdia, Gëzim, *Stadiumi i Amantias, një ndërtim nga më të rrallat në Ballkan*, 55, 10 prill 2007, faqe 7; Llojdia, Gëzim, Gjika, Ilirjan, *Amantia, marrëdhëniet e saj me qendrat e tjera*, Metropol, Tiranë, 1 Tetor 2007.

³ Episkopata e Apolonisë. Nëpër Apoloni kalonte dega jugore e udhës Egnatia në stacionin që romakët e quanin *Clodiana*. Kristjanizimi i Apolonisë mendohet të jetë bërë që në shekullin i pas Krishtit prej apostullit Pavlit, i cili dorëzoi në gradën episkopale Marinin. Në Kodikun e Bibliotekës së Jerusalemit, Marini renditet në vendin e 56 pas shën Qesarit, episkopit të Durrësit. Në vitet e para të përhapjes së krishterimit në Apoloni është martirizuar Ibas, i cili ishte me origjinë nga Athina. Gjithashtu në vitin 283 tre djem nga Athina kishin ardhur në Apoloni për të predikuar krishterimin. Nga praktikat e sinodeve ekumenike vërtetojmë se në Sinodin e Efesit të vitit 431, Mitropolit i Durrësit Efkarios shoqërohej nga ndihmësi i tij episkopi i Apoloniadës dhe i Bulidës Feliksi. Episkopi i Apoloniadës, Eusebi ka nënshkruar aktet e Sinodit IV Ekumenik të Kalqedonisë, i cili u mbajt në vitin 451. Rreth shekullit V Apolonia filloi të braktisej. Popullata u shpërngul drejt qendrave të tjera urbane. Kështu që edhe rezidenca episkopale u zhvendos në qytetin e Bylisit. Rreth vitit 458 episkopi Euseb mori titullin Episkop i Apoloniadës dhe i Bylisit. Pas vitit 458 u fronëzua episkopi Filohar, i cili mori titullin Episkop i Bylisit. Kondili, Pirro, *Apostull Pavli në viset e Shqipërisë së sotme*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 5; Rama, Luan, *Shën Pali, ungjillori i Ilirisë*, Le Radici, Anno 13, n.1, Aprile 2015, pagina 21; Farlati, Daniele, Koleti, Jokob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilia, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963, faqe 186-187; Gjika, Ilirjan, *A e ka vizituar Shën Pali Apoloninë*, Fjala, 22-29 maj 2005, faqe 4.

⁴ Episkopata e Valonës. Aulona (Valona) gjendet mes Apolonisë nga veriu dhe maleve Akroçeraune nga jugu, në brigjet e detit Adriatik në një fushë mes kodrash. Në gjuhën greke fjala *Aulonë* do të thotë *luginë*. Krishtërimi në episkopatën e Aulonës është i hershëm. Këtë e dëshmon martirizimi i Elefërit, episkopit të Vlorës dhe i Ilirisë në shek. II. Gjithashtu Shën Danaksi (+300), që ka qenë anagnost i kishës së Vlorës dhe Ilirisë. Ndër episkopët e episkopatës së Valonës përmendet Naxari, i cili në Sinodin krahinor të Epirit të Ri në vitin 458 ka nënshkruar letrën që iu drejtua perandorit Leon. Episkopi i Valonës Soteri në vitin 553 ka marrë pjesë në Sinodin V Ekumenik të Kostandinopojës, duke pranuar dënimin e tre kapitujve. Në librin e episkopëve pjesëmarrës në Sinod janë emri dhe nënshkrimi i tij. “Soteri shumë i ndershmi episkop i Valonës”. Ndërsa në nënshkrimin e kanoneve të shenjta që u dekretuan në Sinod ai nënshkruan: “Soteri për hir të Zotit, episkop i të shenjtës kishë të Valonës po ashtu”. Farlati, Daniele,

Nga praktikat e sinodeve ekumenike mësojmë se në Sinodin e Efesit të vitit 431, Mitropoliti i Durrësit Efkarios shoqërohej nga ndihmësi i tij episkopi i Apoloniadës dhe i Bulidës Feliksi¹. Duke pranuar dënimin e Nestorit Feliksi ka nënshkruar aktet e Sinodit: “Feliksi, episkopi i Apolonisë dhe Bulinës², duke vendosur bashkë me Sinodin nënshkruaj”. Në një akt tjetër, ku bëhet fjalë për të mbrojtur Kirilin e Aleksandrisë Feliksi ka shkruar: “Unë Feliksi, episkopi i Apoloniadës nënshkruaj”. Episkopi i Apolonisë, Pali ka marrë pjesë në Sinodin e Kostandinopojës të vitit 448. Ai ka nënshkruar përjashtimin e Eftikut nga kisha dhe dënimin e herezisë së tij: “Pali, episkopi i Apoloniadës, gjyqtar i qytetit të shenjtë kishës nënshkrova”. Episkopi i Apoloniadës, Eusebi ka nënshkruar aktet e Sinodit IV Ekumenik të Kalqedonisë, i cili u mbajt në vitin 451. Në katalogun e episkopëve është shkruar: “Eusebi i Apolonisë”. Eusebi i pranoi vendimet e Sinodit dhe nënshkruan letrën e Leonit kundra Eftikut dhe Nestorit. Gjithashtu, Eusebi ka nënshkruar edhe dekretet e botuara në Efes: “Unë Eusebi, episkopi i qytetit të Apolonisë nënshkruaj”³.

Rreth shekullit V Apolonia filloi të braktisej. Popullata u shpërngul drejt qendrave të tjera urbane. Kështu që edhe rezidenca episkopale u zhvendos në qytetin e Bylisit. Rreth vitit 458 episkopi Euseb mori titullin Episkop i Apoloniadës dhe i Bylisit. Pas vitit 458 u fronëzua episkopi Filohar, i cili mori titullin Episkop i Bylisit⁴.

Episkopata e Bylisit, e cila njihej me emrin Validi dhe kishte për Episkop Filoharin⁵, i cili ka marrë pjesë në Sinodin e Kalqedonisë të vitit 458. Në shekullin VI Bylisi radhitet ndër tetë qytetet më të rëndësishme të Epirit të Ri dhe ka qenë qendër episkopale. Kjo është vërtetuar nga zbulimet arkeologjike të një kishe të tipit bazilikal trenefëshe me apsidë gjysmëkëndore⁶.

Ndër episkopët e episkopatës së Valonës përmendet Naxari, i cili në Sinodin krahinor të Epirit të Ri në vitin 458 ka nënshkruar letrën që iu drejtua perandorit Leon. Episkopi i Valonës Soteri në vitin 553 ka marrë pjesë në Sinodin V Ekumenik të Kostandinopojës, duke pranuar dënimin e tre kapitujve. Në librin e episkopëve pjesëmarrës në Sinod janë emri dhe nënshkrimi i tij: “Soteri shumë i ndershmi episkop i Valonës”. Ndërsa në nënshkrimin e kanoneve të shenjta, që u dekretuan në Sinod ai

Koleti, Jokob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilija, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963, faqe 189.

¹ Rama, Luan, *Shën Pali, ungjillori i Ilirisë*, Le Radici, Anno 13, n.1, Aprile 2015, pagina 21.

² Bulida ka qenë një qytet në Epirin e Ri, pranë Apolonisë. Sipas Farlatit, kur vdiq episkopi i Bulidës, atë e ka zëvendësuar Feliksi. Prandaj ai nënshkruan aktet e Sinodit si episkop i dy dioqezave kishtare.

³ Farlati, Daniele, Koletë, Jokob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilija, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963, faqe 186-187.

⁴ Gjika, Ilirjan, *A e ka vizituar Shën Pali Apoloninë*, Fjala, 22-29 maj 2005, faqe 4.

⁵ Rama, Luan, *Shën Pali, ungjillori i Ilirisë*, Le Radici, Anno 13, n.1, Aprile 2015, pagina 21.

⁶ Mërtiri, Irena, *Bylis, qyteti antik pas 10 shekujsh*, Metropol, 30 prill 2007, faqe 18-19.

nënshkruan: “Soteri për hir të Zotit, episkop i të shenjtës kishë të Valonës po ashtu”¹. Amantia përmendet si qendër e rëndësishme episkopale në shekullin V. Ajo ka qenë në varësi të Kryepeshkopatës së Durrësit. Episkopi i Amantias Euali ka marrë pjesë në Sinodin e Sardikës. Ai nuk i pranoi vendimet e Sinodit dhe u largua prej tij bashkë me 71 episkopë të tjerë².

Pushtimi bullgar

Më 860 Beratit e përfshiu vala e parë e pushtimit bullgar, që zgjati deri në vitin 927. Megjithë pushtimin prej barbarëve, popullsia vazhdoi ta ruante besimin e krishterë. Madhështia e krishterimit në trevat e Ilirisë bëri që edhe pushtuesit bullgarë të përqaфонin fenë kristiane. Kristianizmi i bullgarëve u bë në këto rrethana: Një motër e mbretit bullgar Boris, u zu robinë nga bizantinët në luftë dhe u çua në Kostandinopojë, ku u trajtua me shumë dashamirësi nga perandoresha Teodora. Ajo pranoi të kalonte në fenë e krishterë duke u pagëzuar me emrin Maria. Kur u kthye në Bullgari ajo u përpoq të bindte të vëllanë, mbretin Boris, për t’u pagëzuar. Pagëzimi i tij u bë në një ceremoni madhështore në kishën e Ballshit dhe nuni i tij u bë perandori bizantin Mihali III (842-867) me anën e një përfaqësuesi të tij. Borisi (852-889) mori emrin e nunit të tij, Mihal³.

Pas këtij viti në Berat u rikthye sundimi bizantin, që vazhdoi deri në vitin 969. Pas këtij viti filloi vala e dytë e pushtimit bullgar, që vazhdoi deri në vitin 1018. Në këtë kohë bullgarët Beratit e quajtën Beligrad (Βελαγραδον)⁴, që do të thotë *qyteti i bardhë*. Në fillim të shekullit X Durrësi u bë qendër kryepeshkopale dhe kishte në varësi 15 episkopata: Stefaniaka, Kunavia, Krooni (Kruja), Elisu (Lezha), Dioklea, Skodra, Drivasti, Polathon, Glavinica, Aulona (Vlora), Likinidon (Ulqini), Antivaros

¹ Farlati, Daniele, Koletë, Jakob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilija, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963, faqe 189.

² Farlati, Daniele, Koletë, Jakob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilija, AQSH, Dosja Nr.40, Viti 1963, faqe 185.

³ Gjatë Luftës së Parë Botërore një oficer austriak i quajtur Kamilo Prashniker zbuloi në Ballsh të Mallakastrës një mbishkrim në greqishten bizantine të gdhendur në një shtyllë mermeri të lartë 1.60 metra: ...εβαπίστη ο αρχων Βουλγαρείας Βορης ο μετονομασθεις Μιχαηλ συν τω εκ Θεου δεδομενω αυτω εθνει. ε(ις) τους σ τ ο δ (6374=866). “...u pagëzua sundimtari i Bullgarisë Borisi Car, (Fig.11) i quajtur Mihal së bashku me popullin e tij, të dhënë prej Perëndisë në vitin 6374”. Mbishkrimi u zbulua në vitin 1918, (Fig.12) nga ushtarët austriakë ndërsa punonin për të nxjerrë gurë nga gërmadhat e kishës së Ballshit dhe u dërgua në Durrës, në vendin ku mbaheshin objektet arkeologjike. Mbishkrimi daton më 6374, që është dhënë sipas kalendarit bizantin, ku sipas kalendarit të ri Gregorian i përket vitit 866 pas Krishtit. Pagëzimi i Borisit u bë në një ceremoni madhështore dhe nuni i tij u bë perandori bizantin Mihali III (842-867), me anën e një përfaqësuesi të tij. Borisi (852-889) mori emrin e nunit të tij, Mihal. Sipas studiuësit Ilirjan Gjika në vitin 886, Borisi dërgoi si misionar, Klementin e Ohrit (886-916). Popa, Theofan, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1998, nr. 82, fq. 79.

⁴ Xhufi, Pëllumb, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora nëshekujt XII-XV*, Shtëpia botuese 55, Tiranë: 2009, faqe 26-27.

(Tivari), Cerniku, **Pulqeriopoli** dhe Gradeci¹. Në fillimet e shekullit IX Berati u pushtua nga sllavët, të cilët filluan ta quajnë Beligrad. Në letër që papa i Romës Joani XII i dërgon Borisit të bullgarëve e vlerëson Beligradin si një seli të rëndësishme episkopale. Ndërsa Theofilakti i Ohrit e vlerëson episkopin e Beratit si “një njeri që shkëlqen nga dijet”. Me krijimin e Kryeepiskopatës së Ohrit më 1020, Berati² kaloi në juridiksionin e kësaj episkopate. Në jetëshkrimin e Shën Klementit, shkruar nga Theofilakti (1094-1107) theksohet fakti se: “Boris i dhuroi Shën Klementit vende për pushim në Ohër dhe në Gllavenicë”. Sipas peshkopit të Ohrit Dhimitër Homatiani (1216-1234) mësojmë faktin se: “Kohën më të madhe Klementi e kalonte në Ohër dhe në Kefalini, që në gjuhën bullgare quhej Gllavenicë”. Gjithashtu mësojmë se Klementi ndërtoi disa kisha në Gllavenicë³. Vite më vonë u përhap kulti i "Shtatë Shenjtorëve", në të cilin bëjnë pjesë shenjtorët Kiril dhe Metod dhe nxënësit e tyre Gorazhdi, Klimi, Naumi, Angjellari dhe Sava. Nuk kemi saktësi në përcaktimin se si u krijua tradita e kultit të shtatë shenjtorëve, por ata i përmend vetëm Theofilakti në jetëshkrimin e shenjtorit Klement të Ohrit. Vite më vonë Gorazhdi e vazhdoi veprimtarinë e tij në

¹ Meksi, Aleksandër, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV)*, Uegen, Tiranë: 2004, faqe 50-58.

² Në vitin 1018, pas shkatërrimit të shtetit Bullgar të Samuelit, u krijua një kryeepiskopatë e madhe dhe e pavarur, e cila ishte Kryeepiskopata e Ohrit. Perandori Vasili II Bullgaroktoni, në vitin 1020 ka nxjerrë tri dekrete me rëndësi për Kryeepiskopatën e Ohrit, ku Joani është caktuar Kryeepiskop i Ohrit dhe ka pasur në juridiksionin e tij 32 episkopata, të cilat qenë: 1. Achrida (Ohri), ku ishte edhe rezidenca e kryeepiskopit, 2. Kastoria (Kosturi), 3) Glabiniza (Gllavinica), 4. Moglaena (Moglena), 5. Buetis (Vuteli në Pelagoni ose Manastiri i sotëm), 6. Strumnitza (Strumnica), 7. Morobisdos (Morovizda), 8. Belebusda (Velevuzda), 9. Triaditza (Triadica, Sofia), 10. Nisos (Nishi), 11. Branitza (Vranica), 12. **Belegrada (Berati)**, 13. Thronia (Striamos, Zemlin), 14. Skopia (Shkupi), 15. Prizdriana (Prizreni), 16. Lipainion (Lipjani), 17. Serbia (Servia, qytet në Maqedoninë Jugperëndimore), 18. Dristra (Drster), 19. Bodina (Vidini), 20. Rhasos (Rasa, Novipazari), 21. Horaeja (Oreja), 22. Tzernikos (Cerniku, ndoshta Cërriku), 23. Chimaira (Himara), 24. Adrianupilos (Drinopolis), 25. është fshirë, 26. Bothroton (Butrinti), 27. Joannina (Janina), 28. Kozila (Kozili), 29. Petros (Petra), 30. Rogia, 31. Stagoi, 32. Berroia.

³ Gllavenica përmendet në zbarkimin e parë të normanëve në bregdetin shqiptar në fundin e shek. IX. Gjatë fushatës së dytë të normanëve në vitet 1107-1108, në Gllavenicë u vra fisniku norman Robert de Monteforte. Ndonëse mbante titullin dukë, ai u varros me shpejtësi dhe mbi varrin e tij u vendos shtylla e gurit mbi të cilën ishte gdhendur kthimi i mbretit Boris në krishtërim. Duke mos njohur greqishten gurgdhendësi shkruajti në pjesën e mbetur të shtyllës 14 vargje në gjuhën latine. +Hic est subpositus de Forti Mon(t) e Robert(us) Corpore formosus prob(us) armis vir generos(us) Subduce Normanni Cuntis quoq inventutis dives floreret in anni(s) Deseruit mundun D(omi)niq(ue petendo sepulcr(um) Hic obiit Ph(o)eb(o) (i)a(m) sub Libra quat(er) ort(o) Det Roberto tib(i) (S)ua gandia rex para(disi). “+Këtu është varrosur Robert de Forti Monte. I hirshëm në trup, trim në armë, burrë bujar nënkomandant i normanëve. Që në krye edhe mbi të gjithë englezët Angli(s) duke qenë në moshë më të bukur të rinisë e braktisi botën duke kërkuar varrin e zotërisë. Këtu vdiq i ri kur dielli lindi për të katërtën herë në hyllësinë e librës. Të dhëntë o Robert. Mbreti i paradisit gëzimet e veta”. Shtylla e gurit shërbeu si epiraf varri për kalorësin norman. Popa, Theofan, *Mbishkrimet e kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1998, nr. 83, faqe 80.

Berat ku edhe u martirizua. Në katedralen e “Shën Marisë” në Berat ndodhen lipsanët e tij dhe të Angjellarit¹.

Gjithashtu një ikonë e kësaj kishe paraqet fjetjen e shenjtorëve. Ekziston edhe një shërbesë e shkruar greqisht për nder të shtatë shenjtorëve. Nga kjo akoluthi ruhet vetëm një kopje, e cila është shtypur në Venedik me shpenzimet e zotërinjve Andrea Papa, Joan Papa dhe të bijve të tij, Nikollës dhe Anastasit. Në shërbesë bëhet fjalë për nderimin e Angjellarit dhe të Gorazhdit në zonën e Beratit. Akoluthia shpesh përmend lipsanat e tyre të shenjta: "Grumbulli me lipsanat e Shtatë shenjtorëve, burim jetëdhënës për besimtarët..". Masa e besimtarëve i shpalli mbrojtës të qytetit, prandaj u hartua edhe akoluthia për nder të shtatë shenjtorëve².

Me rënien e Perandorisë Bizantine më 1204, Berati u bë një nga selitë më të rëndësishme të Despotatit të Epirit. Mihal Komneni, despoti i Epirit rezidencën e vendosi në Berat³. Pinjulli i familjesë së shquar të Komnenëve u shua më 1216, por pasardhësit e tij e ruajtën sundimin edhe për gjysmë shekulli.

Në vitin 1274 shfaqet familja e Muzakajve, ku Gjon Muzaka ka qenë njëri nga dy të dërguarit e fisnikërisë shqiptare te Karli I Anzhu. Më 11 tetor 1279 Gjon Muzaka u arrestua nga anzhuinët dhe u lirua nga presioni i fisnikëve arbër më 30 korrik 1280. Muzakajt qenë një ndër familjet më të fuqishme shqiptare që kishin një qëndrim të pavarur si ndaj Bizantit ashtu edhe ndaj anzhuinëve. Titujt e Andrea Muzakës *marshal i mbretërisë së Arbrit*, të Mentul Muzakës *kont i Këlcyrës* dhe të Teodor Muzakës *protosebast* dëshmojnë se kjo familje në fillim të shek. XIV ishte një nga familjet kryesore feudale të Shqipërisë. Andrea Muzaka II luftoi me mbretin Vukshanin dhe e theu atë. Për këtë akt perandori i dha stemën e tij, domethënë shqiptonjën me dy krerë me yll në mes si edhe titullin *despot i Epirit*. Sipas kronikës së Gjon Muzakës: Zoti Andrea Muzaka me titullin sebastikator zotëronte qytetin e Belgradit, që ishte kreu i Myzeqesë. Anën e Myzeqesë, Tomonishën, që është Myzeqeja e Vogël, vendin e Selenicës deri në det etj. Ndarja e principatës në katër pjesë solli dobësimin e Muzakajve. Me këtë ndarje Andrea Muzaka II i la të birit të parë tërë restin e shtetit; të dytit, Theodorit, Belgradin dhe Muzakien; të tretit, Stojës, Kosturin dhe së fundi së bijës, Komitës, Vlorën dhe Kaninën⁴.

Më 1345 Berati bie nën sundimin e mbretit serb Stefan Dushan. Despot i tokave të Kaninës dhe të Beratit u caktua Joan Komneni, që ishte kunati i Stefan

¹ Nihoritit, Kostas *Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve*, 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri, Tiranë: 2003, faqe 87-90.

² Nihoritit, Kostas, *Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve*, Ngjallja, qershor 2002, faqe 9,10.

³ Ky fakt vërtetohet nga një monogram me tulla që gjendet mbi hyrjen e portës veriore të kalasë: një kryq me katër shkronja M H L K që transkriptohet me emrin e despotit M(i) H(a) L K(omneni). *Berati, Historia, arti, kultura dhe informacione të ndryshme*, Mars 2000, faqe 12-13.

⁴ Baçe, Apolon, Meksi, Aleksandër, Riza, Emin, *Berati historia dhe arkitektura, Shtëpia botuese 8 nëntori*, Tiranë: 1988, faqe 22-24.

Dushanit. Në vitin 1417 Berati pushtohet nga osmanët gjatë sundimit të sulltan Mehmet Ngadhënjimtarit. Emrin Berat e mori në vitin 1431, në kohën e pushtimit osman¹. Në dokumentet osmane qyteti i Beratit përmendet në formën “Arnavut Belgrad”, që do të thotë (Beogradi shqiptar)². Pra fillimisht quhej Antipatrea, në vijim Pulqerionopolis, Beligrad dhe më në fund Berat³. Në regjistrin osman të vitit 1431 në kalanë e Beratit numërohen 227 familje, me 1500 banorë.

Pas shpërbërjes së Kryeepiskopatës së Ohrit⁴ në vitin 1767, Mitropolia e Beratit hyri në listën e mitropolive të Kostandinopojës. Mitropoliti⁵ mbante titullin: “I Përndershmi Mitropolit i Beligradit dhe i Kaninës”. Në shekullin XVII, Berati qe në sundimin e Ahmet Kurt pashës dhe u bë qendra e pashallëkut të Beratit. Pas vitit 1810 pashallëku i Beratit u bashkua me pashallëkun e Janinës⁶. Berati mori pamjen

¹ Sipas regjistrin kadastral të vitit 1431-1432 Sanxhaku Shqiptar ishte i ndarë në 11 vilajete, të cilat më vonë u quajtën kaza. Vilajeti i Gjirokastrës, i Këlcyrës, i Kaninës, i Beratit, i Tomoricës, i Skraparit, i Pavël-Kurtikut, i Çartallozit, i Krujës, i Përmetit dhe i Korçës. Në krye të vilajetit ishte subashi, komandanti i spahinjve. Çdo vilajet kishte kadiun si kryetar të Sheriatit (ligjit të shenjtë). Kadiu gjykonte çështjet administrative, civile dhe fetare të popullsisë. Biçoku, Kasem, *Skënderbeu*, Akademia e Shkencave, Tiranë: 2005, faqe 55-58.

² *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2017, faqe 8.

³ Kaja, Arjan, Shyti, Xovani, *Berati, gur i rëndë në historinë e qytetërimit shqiptar*, Tema, 26 dhjetor 2007, faqe 12-13.

⁴ Jetëgjatësia e Kryeepiskopatës së Ohrit ishte deri më 16 janar të vitit 1767 kur Kryeepiskop Arseni dha dorëheqjen nga posti. Shkaku i dorëheqjes së tij qenë mosmarrëveshjet me mitropolitët që kishte në varësi. Në vjeshtën e vitit 1766 pesë mitropolitë shkuan në Kostandinopojë dhe i kërkuan patrikut Samuelit I (1763-1768) shkëputjen nga Kryeepiskopata e Ohrit duke firmosur një *Premtim*, me anën e së cilit i nënshtroheshin autoritetit të Kostandinopojës. Me kërkesë të patrikut Samuel I, sulltan Mustafai e miratoi vendimin për suprimimin e Kryeepiskopatës së Ohrit dhe krijimin e Kryeepiskopatës së Durrësit. Të gjitha dioqezat e Shqipërisë që vareshin nga Kryeepiskopata e Ohrit, madje edhe Ohri vetë, tanimë si episkopatë e thjeshtë u vunë në varësi të Durrësit, që u ngrit në rangun e Kryeepiskopatës. Qazimi, Azem, *Fjalor i Krishtëritimit*, Plejad, Tiranë: 2011, faqe 253-262.

⁵ Sipas radhës kronologjike disa nga Mitropolitët e Beratit kanë qenë: Nektari (1668), Partheni (1683), Ignati (1685), Nektari (1699), Dionisi (1710), Theodhosi (1715-1716), Niqifori (1718-1725), Kozmai (1727-1734), Metodi (1736- 1751), Joasafi (1725-1759), Efthimi i dytë (1761-1763), Partheni (1763-1765), Joasafi përsëri (1765-1767), Ioaniqi (1768-1769), Gjerasimi (1769-1772), Joasafi (1772), Meleti (1800), Joasafi (1802), Anthimi (1855), Vasili (1900), Kaliniku (1909), Ioanqi (1911), 1911-1923 pa Mitropolit, Kristofor Kisi (1923), Agathangjel Çamçe (1929), Visarion Xhuvani (1941), Kirilli (1949), Ignat Trianti 24 qershor 1992 u bë zgjedhja dhe më 18 korrik 1998 u bë fronëzimi. Çuko, Maksim, *Qytetërimi dhe krishterimi në Myzeqe*, Tekno Peper, Tiranë: 2004, faqe 42.

⁶ Sanxhaku i Beratit në vjetërsit osmanë varej nga vilajeti i Janinës. Berat është emir i kazasë, që është qendra e sanxhakut me të njejtin emër. Kazaja e Beratit kufizohet në lindje me Tomoricën dhe Skraparin, në perëndim me detin Adriatik dhe skelën e Semanit, në jug me kazanë e Tepelenës dhe me lumin Vjosa dhe në veri me sanxhakët e Elbasanit dhe Durrësit. Sanxhaku i Beratit e ka qendrën në Berat. Në varësi të tij janë kazatë Berat, Vlorë, Skrapar dhe Tomoricë si dhe nahijet Lushnjë, Rreth Myzeqe, Plashnik, Mallakastra e Sipërme, Mallakastra e Poshtme dhe Kapinova. *Berati në dokumentat arkivore osmane*, Stamboll: 2013, faqe 17.

që ka sot aty nga fundi i shek. XIX, pas tërmetit¹ të vitit 1851. Në fund të viteve 1800 Berati kishte rreth 820 punishte zejtarie dhe dyqane. Me anën e një fermi qe daton më 1804 urdhërohet dërgimi i ustallarëve nga Berati për të restauruar rrugët prej kaldrëmi të Stambollit². Sipas regjistrit të popullsisë në vitin 1880 në kazatë dhe nahijet që varen nga sanxhaku i Beratit³ rezultoi se popullsia e përgjithshme e sanxhakut ishte 76216 banorë, prej të cilëve 57674 qenë myslimanë dhe 18542 qenë ortodoksë. Sipas vjetarit të Janinës të vitit 1892 popullsia e Beratit ka qenë rreth 10 mijë banorë. Nga këta 4799 qenë meshkuj dhe 4563 qenë femra. Numri i shtëpive ka qenë 1649. Popullsia e përgjithshme e kazasë ka qenë 68011 banorë. Kazaja kishte një nahije, 218 fshatra dhe 11802 shtëpi⁴.

Bibliografi

- Baçe, A, Meksi, A, Riza, E, *Berati historia dhe arkitektura, Shtëpia botuese 8 nëntori*, Tiranë: 1988.
- Gjika, Ilirjan, *Apolonia, krishtërimi dhe Shën Pali*, Metropol, 16 prill 2007, faqe 20-21.
- Gjika, Ilirjan, *A e ka vizituar Shën Pali Apoloninë*, Fjala, 22-29 maj 2005, faqe 4.
- Farlati, Daniele, Kolet, Jakob, *Illyricum Sacrum*, Vëllimi VII, dorëshkrim i përkthyer nga latinishtja nga Franko Ilia, Arkivi Qendror i Shtetit, Dosja Nr. 40, Viti 1963.
- Kaja, Arjan, Shyti, Xovani, *Berati, gur i rëndë në historinë e qytetërimit shqiptar*, Tema, 26 dhjetor 2007, faqe 12-13.
- Kondili, Pirro, *Apostull Pavli në viset e Shqipërisë së sotme*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 5.
- Llojdia, Gëzim, *Stadiumi i Amantias, një ndërtim nga më të rrallat në Ballkan*, 55, 10 prill 2007, faqe 7.
- Meksi, Aleksandër, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV)*, Uegen, Tiranë: 2004.

¹ Në ferman është shkruar: "Kërkesa e kajmakanit të Beratit, Mustafa Ataulahut që mos ti zihet për e madhe mangësitë që ka treguar në përmbushjen e detyrave administrative dhe në mbledhjen e taksave pasi ai ka vënë në punë të gjithë mundësitë që zotëron në mënyrë që të zgjidhë shqetësimet dhe problemet që kanë buruar **nga tërmeti që ka rënë në Berat më datë 12 tetor 1851, ditën e dielë, rreth orës një**. Si rezultat i këtij tërmeti janë shkatërruar shumë shtëpi, kisha e xhami në kasabanë e beratit dhe në fshatrat e saj, se ato që kanë mbetur në këmbë janë gati për tu shembur, se populli bashkë me fëmijë kanë filluar të qëndrojnë përjashtë pasi nuk ka mbetur ndërtesë dhe se tërmeti ka shkaktuar shumë shkatërrime si dhe shumë humbje jetësh të njerëzve. 17 Zilhicce 1267/ 12.10.1851". *Berati në dokumentat arkivore osmane*, Stamboll: 2013, faqe 43.

² Në ferman është shkruar: "Urdhri i sulltanit dërguar mytesarifit të sanxhakut të Vlorës, vezir Ibrahim pashës, në mënyrë që të dërgojë menjëherë drejt Stambollit një numër të mjaftueshëm nga mjeshtrit e Beratit, në të cilin ka një aktivitet të madh esnafi i mjeshtërive të kalldrëmeve, sepse kalldrëmet e rrugëve kryesore dhe dytësore të Stambollit, kryeqytetit të perandorisë osmane janë prishur aq sa kanë nevojë për një riparim të menjëhershëm dhe esnafi i punuesve të kalldrëmeve, që gjenden në Stamboll dhe kapin shifrën 40 esnafa nuk janë të mjaftueshëm për të përmbushur këtë detyrë". Evail-i Sevval 1218/ 23.09.1804. *Berati në dokumentat arkivore osmane*, Stamboll: 2013, faqe 42.

³ *Berati në dokumentat arkivore osmane*, Stamboll: 2013, faqe 48.

⁴ Sami, Shemsedin, *Berat, Kamusu-Alam*, vëll.II, Stamboll: 1306, faqe 1260.

Meksi, Aleksandër, *Kisha paleokristiane në qytetin e Amantias*, Albania, 7 shtator 2007, faqe 21.

Nihoritis, Kostas, *Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve*, 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë: 2003.

Nihoritis, Kostas, *Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve*, Ngjallja, qershor 2002, faqe 9,10.

Popa, Theofan, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1998.

Qazimi, Azem, *Fjalor i Krishtëritimit*, Plejad, Tiranë: 2011.

Rama, Luan, *Shën Pali, ungjillori i Ilirisë*, Le Radici, Anno 13, n.1, Aprile 2015, pagina 21.

Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2017.

Xhufi, Pëllumb, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII-XV*, Shtëpia botuese 55, Tiranë: 2009.